TAKIMI I DYTË 2026 - KOMITETI SEKTORIAL I MIKPRITJES DHE TURIZMIT

Takimi i dytë i Komitetit Sektorial të Mikpritjes dhe Turizmit u zhvillua në datë 29.06.2026.

Mbledhja u hap duke u theksuar rëndësia e rolit të Agjencisë Kombëtare të Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve në përgatitjen e stafeve dhe punonjësve me kompetencat e nevojshme për zhvillimin e sektorit të turizmit.

Në pjesën e parë të mbledhjes u bë një përmbledhje e vendimeve dhe dakordësimeve të arritura në takimin e parë të Komitetit Sektorial për vitin 2026, me fokus ndryshimin e strukturës së kualifikimeve profesionale në fushën Hoteleri - Turizëm nga strukturat 2 + 1 + 1 dhe 2 + 2 në strukturat 3 + 1 dhe 4-vjeçare bllok, që do të sillte riorganizimin e kualifikimeve ekzistuese.

Nisur nga sa më sipër, anëtarët e Komitetit Sektorial diskutuan mbi mënyrën e riorganizimit të kualifikimeve profesionale ekzistuese, përmbajtjen e tyre dhe emërtimet e çdo kualifikimi profesional të ri. Pas diskutimeve, anëtarët dakordësuan dhe miratuan ofrimin e tre kualifikimeve profesionale me kohëzgjatje 3 vjet bllok: *"Kuzhinë Profesionale", "Shërbime hotelerie"* dhe *"Shërbime në restorant dhe në bar"*, si dhe ofrimin e kualifikimit profesional: *"Shërbime turizmi dhe udhërrëfimi"* me kohëzgjatje 4 vjet bllok. Krahas kësaj, Komiteti Sektorial vendosi ofrimin e kualifikimit pas të mesëm me kohëzgjatje 1 vit për: *"Pastiçeri"*.

Në pjesën e dytë të mbledhjes u prezantua standardi i profesionit *"Menaxher në Operator Turistik"*, niveli V në KSHK, që kishte ardhur si propozim nga mbledhjet e mëparshme të Komitetit Sektorial, në përgjigje të kërkesave të tregut të punës dhe nevojës për të ofruar mundësi kualifikimi për individët që synonin të ndryshonin profilin profesional. Standardi i profesionit u miratua pa ndryshime përmbajtësore, por nisur nga funksionet dhe detyrat që ky standard përmbante u vendos që të titullohej: *"Menaxher në Agjenci Udhëtimi"*.

Në vijim, u prezantua dhe u diskutua standardi i kualifikimit profesional të nivelit V të KSHK-së: *"Operator Turistik"*. Anëtarët diskutuan dhe propozuan ndryshime të vogla në % e disa njësive të të nxënit, që ishin teknike dhe miratuan emërtimin e kualifikimit profesional si: *"Shërbime mikpritje dhe turizmi"*. Dokumenti u validua pas ndryshimeve përkatëse. Në përfundim anëtarët propozuan që kualifikimi profesional të ofrohej në formën e arsimit të dyfishtë.

Mbledhja u mbyll me përcaktimin e agjendës për mbledhjen e radhës dhe falenderimin e pjesëmarrësve dhe anëtarëve për kontributin e dhënë.

- **Vendime të marra nga mbledhja:**

  - U përcaktuan emërtimet e kualifikimeve profesionale me kohëzgjatje 3 vjet bllok: *"Kuzhinë profesionale", "Shërbime hoteliere"* dhe *"Shërbime në restorant dhe bar"*.

- U përcaktua emërtimi i kualifikimit profesional me kohëzgjatje 4 vjet bllok *"Shërbime turizmi dhe udhërrëfimi"*.
- U përcaktua ofrimi i kualifikimit pas të mesëm me kohëzgjatje 1 vit për *"Pastiçeri"*.
- U validua pa ndryshime përmbajtësore standardi i profesionit: *"Menaxher në Operator Turistik"*. U vendos ndryshimi i emërtimit të standardit të profesionit: *"Menaxher në Agjenci Udhëtimi"*.
- U validua pas disa ndryshimeve të vogla në % të disa njësive të të nxënit standardi i kualifikimit profesional: "*Operator Turistik"*, niveli V në KSHK. U vendos ndryshimi i emërtimit të standardit të kualifikimit profesional në *"Shërbime mikpritje dhe turizmi"*.